

Raport Përfundimtar i Monitoruesve

I. Përmbledhje

Vëzhguesi: (Emri, mbiemri)	
Rajoni/ Njësia administrative e monitoruar:	Velipojë Bashkia Shkodër Njësia administrative Velipojë, Bërdicë, Dajç, Ana e malit
Subjektet Zgjedhore të monitoruar:	Partia Demokratike
Periudha e mbuluar nga raporti:	13/02/2022-06/03/2022
Data e dorëzimit të raportit:	13/03/2022
Nënshkrimi	

Shënim: për Seksionin II (monitorimi i aktiviteteve të fushatës), një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e dhënë. Për seksionin III (monitorimi i abuzimeve/ keqpërdorimeve të burimeve shtetërore), një raport duhet të plotësohet për të gjithë zonën gjeografike të monitoruar.

II. Subjekti Zgjedhor – AKTIVITETET E MONITORUARA TË FUSHATËS

Një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e mëposhtëm.

Raporti i Monitorimit për Subjektin Zgjedhor **Partia Demokratike Xhemal Bushati** (shtoni emrin e subjektit zgjedhor)

1. Përmbledhja e aktiviteteve të monitoruara të subjektit zgjedhor

Lloji i aktivitetit të monitoruar	Detaje
--	---------------

a) Zyrat Zgjedhore	Vendndodhja e zyrave zgjedhore të monitoruara Bulevardi Mehmet Pashë Plaku Rruga Edith Durham Rruga Europa
--------------------	---

b) Ngjarjet e Fushatës

Numri i plotë i ngjarjeve të monitoruara të fushatës të mbajtura nga E/s që CM monitoroi

Numri i ngjarjeve të monitoruara të fushatës Përfshirë edhe ditën e Zgjedhjeve është 25

Gjatë zgjedhjeve nuk kishte asnjë problem.

#	Vendodhja	Ora dhe Data	Nr. i të pranishëmve	Detaje të tjera (pajisje teknike, materialet e fushatës etj.)
1	Shkodër/Tregu artizanal	Ora 11:29 Data 13/02/2022	30	Kamera për bërjen e fotografive nga Takimi.
2	Dajç/ Lokal Privat	Ora 1:53 Data 13/02/2022	40	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me banorët.
3	Dajç/ Në biznesin e Gjegj Lucaj	Ora 2:20 Data 13/02/2022	10	Kamera për bërjen e xhirimeve dhe fotografive nga takimi me Biznesmenin.
4	Postribë Në një lokal privat	Ora 6:16 Data 16/02/2022	40	Kamera për bërjen e fotografive nga Takimi elektorale.
5	Betonalja/Shkodër	Ora 11:20 Data 19/02/2022	4000	Banderola, Flamuj, Podium për fjalim.
6	Banorët e Rajonit numër 5	Ora 11:00 AM Data 26/02/2022	Rreth 30 qytetarë përfshirë në të dhe stafin e Kandidatit të Partisë Demokratike.	Kamera për bërjen e fotografive nga takimi me banorët.

7	Teatri Migjeni	Ora 14:44 PM Data 26/022022	Rreth 300 qytetarë, përfshirë në të dhe stafin e Kandidatit të Partisë Demokratike	Kamera për bërjen e fotografive dhe xhirimeve nga takimi elektoral. Podium, Banderola me logon e Kandidatit të Partisë Demokratike 6*2.5 M2.
8	Shkodër/ Hotit, Grudës, Bardhaj/ Në një Lokal Privat.	Ora 6:18 PM Data 27/02/2022	Rreth 50 qytetarë përfshirë në të dhe stafin e Kandidatit të Partisë Demokratike.	Kamera për bërjen e fotografive dhe xhirimeve nga takimi elektoral me banorët e Hotit, grudaj, Dhe Bardhaj.
9	Shkodër /Velipojë në një Lokal Privat	Ora 12:10 PM Data 28/02/2022	Rreth 40 qytetarë përfshirë në të dhe stafin e Kandidatit të Partisë Demokratike.	Kamera për bërjen e fotografive dhe xhirimeve nga takimi me banorët e Velipojës, banderola me logon e kandidatit të partisë Demokratike
10	Shkodër/Biznes Privat	Ora 3:00 PM Data 28/02/2022	Rreth 15 Qytetarë përfshirë në të dhe	Kamera për bërjen e fotografive dhe xhirimeve nga takimi elektoral, Banderola

			stafin e Kandidatit të Partisë Demokratike	me logon e Kandidatit të Partisë Demokratike.
11	Shkodër/Bërdicë Lokal Privat	Ora 11:35 AM Data 01/03/2022	Rreth 50 qytetarë përfshirë në të dhe stafin e Kandidatit të Partisë Demokratike	Kamera për bërjen e fotografive dhe xhirimeve nga takimi, Banderola me logon e Kandidatit të Partisë Demokratike, Flamur i partisë demokratike.
12	Shkodër/ Me Banorët e Lagjes numër 4 Në një Lokal Privat.	Ora 12: 10 PM Data 03/03/2022	Rreth 100 Qytetarë përfshirë në të dhe stafin e Kandidatit të Partisë Demokratike.	Kamera për bërjen e fotografive dhe xhirimeve nga takimi elektorale, Banderola me logon e Kandidatit të Partisë Demokratike.
13	Shkodër/ Me Banorët e Lagjes nr 1 Në një Ambient Privat.	Ora 10:00 AM Data 04/03/2022	Rreth 50 qytetarë përfshirë në të dhe stafin e kandidatit të partisë Demokratike.	Kamera për bërjen e fotografive dhe xhirimeve nga takimi me banorët e Lagjes numër 1. Banderola me logon e Kandidatit të Partisë Demokratike.

14	Shkodër/Postribë në një ambient Privat.	Ora 14:00 Data 04/03/2022	Reth 50 qytetarë përfshirë në të dhe stafin e kandidatit të partisë Demokratike.	Kamera për bërjen e fotografive dhe xhirimeve nga takimi elektorale. Banderola me logon e Kandidatit të Partisë Demokratike.
15	Shkodër/Në sheshin Para Bashkisë Shkodër	Ora 14:00 Data 04/03/2022	Rreth 2000 Qytetarë përfshirë në të dhe stafin e kandidatit të partisë Demokratike, Dhe kryetarin e Partisë Demokratike.	Kamera për bërjen e fotografive dhe xhirimeve nga takimi elektorale, Podium, Banderola me Logon e Partisë Demokratike.

c) Materialet propagandistike

Numri i plotë materialeve propagandistike të monitoruara (të bashkangjiten mostra/foto për secilen)
5 materiale propagandistike të monitoruara







Numri i plotë i materialeve vizive propagandistike të shqyrtuara për përfshirjen e shënimit: 'Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...'

S'ka

d) Monitorimi i Faqeve të internetit

Listë gjithëpërfshirëse e platformave të faqeve të internetit të monitoruara

Xhemal Bushati

Facebook

#	Platforma	Dita e postimit/ reklamës	Llogaria	Detaje të tjera (përmbajtja, audiencia e synuar.)
1	Facebook/Xhemal Bushati	13/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Këto janë ndër ditët më të veçanta për mua. Po shkoj kudo, tek qytetarët e Shkodrës. Urtësia e shkodranëve dhe dashnia për Shkodrën është në çdo kohë frymëzuese. Janë larg mllëfit. Kanë nevojë të dëgjohen. Por jo vetëm kaq. Unë do t'i bëj pjesë të vendimmarrjes. Në një Bashki të hapur, ku qytetari dëgjohej dhe bashkëqeveris!</p> <p>#medashniperShkodren #votoXhemalBushati #voto3 #pd Audiencia e synuar: Janë Banorët e qytetit të Shkodrës.</p>

2	Facebook/Xhemal Bushati	13/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja:</p> <p>Takova banorët e njësisë Dajç të cilëve u premtova përkushtimin tim të plotë për të zgjidhur problemet që ata kanë, si Kryetar i ardhshëm i Bashkisë Shkodër.</p> <p>Dajçi është njësi administrative e cila për 30 vite me radhë ka mbështetur Partinë Demokratike duke votuar pa asnjë mëdyshje. Edhe në zgjedhjet e 6 marsit vota e banorëve të Dajçit do t'i mbetet besnike e Partisë Demokratike.</p> <p>Arben Gjuraj, ish nënkryetari i bashkisë Shkodër, tha se janë një komunitet që mburret se e mbajnë fort njëri-tjetrin, por edhe miqtë sigurisht, dhe se e kanë të vështirë t'i ndahen fjalës dhe besës së dhënë, e kjo nuk ka ndodhur kurrë këtu në Dajç.</p> <p>“Shkodra ka djem shumë, ka profesionistë të nderuar, mirëpo në momente të vështira, atëherë kur kërkohet më shumë mirëkuptim dhe kur është më i nevojshëm bashkimi se gjithçka tjetër, duhen edhe burra që bashkojnë”.</p> <p>Me këto fjalë më dha sigurimë për mbështetje të plotë, duke më vënë në dukje përbashkimin, në shenjë domosdoshmërie për gjithë qytetarët e Shkodrës</p> <p>Dajçi është një kështjellë shumë e rëndësishme që e ka fituar Partia Demokratike në këto 30 vite.</p> <p>Unë u premtova që vendimarrjet për Dajçin do t'i bëjnë vetë, do të vendosin çfarë do bëhet në</p>
---	-------------------------	------------	----------------	--

				<p>Dajç, dhe unë vetëm do t'i zbatoj. Do të punojmë të gjithë bashkë. Shërbimet do të kryhen në mënyrën më të përsosur.</p> <p>Bujqësia është pikë kyçe për Dajçin dhe ne do ta mbështesim. Kërkova mendimin e tyre dhe mbajta shënime sepse do të bëjmë më të mirën sëbashku për Dajçin, dhe për njësitë e tjera administrative të Shkodrës.</p> <p>Administratori, Gjovalin Darragjati deklaroi se janë munduar të bëjnë më të mirën, dhe se do të vazhdojnë ta bëjnë me mbështetjen e tyre në unitet me njeri-tjetrin. Dokumentimi i pronave është një prej problemeve kryesore dhe u premtova banorëve të Dajçit se bashkia e Shkodrës do jetë një bashkëbisedues i jashtëzakonshëm për këtë çështje.</p> <p>Audienca e synuar: Janë banorët e Zonës Administrative Dajç.</p>
3	Facebook/Xhemal Bushati	14/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja:</p> <p>Unë nuk premtoj mrekulli dhe këtë ua them çdo tregtari që po takoj. Vij nga fusha e biznesit dhe e di se nuk është e lehtë për tregtarët e Shkodrës. Ua di hallet. Prandaj, përpara fjalëve të bukura, premtoj angazhime konkrete. Me një Bashki në krah që i dëgjon dhe i mbështet, biznesi në Shkodër do të ecë përpara.</p> <p>#medashniperShkodren #votoXhemalBushati #voto3 #pd</p> <p>Audienca e synuar: Janë tregtarët dhe bizneenët shkodranë.</p>

4	Facebook/Xhemal Bushati	14/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Mes bashkimit dhe përçarjes, qytetarët e Shkodrës po e japin përgjigjen. Të bashkuar për Shkodren. Kemi shumë punë për të bërë, prandaj duhet ndihma e secilit prej nesh.</p> <p>Me një Bashki të hapur, ku qytetari dëgjohet dhe bashkëqeveris, Shkodra do të fitojë. Ftoj këdo që 6 Marsi të mos jetë thjeshtë një datë, por festa ku qyteti fiton.</p> <p>Shkodra, një qytet, një krenari!</p> <p>#medashniperShkodren #votoXhemalBushati #voto3 #pd Audienca e synuar: Janë tregtarët dhe biznesmenët shkodranë.</p>
5	Facebook/Xhemal Bushati	15/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Një vizitë tek Opportunity, ku nuk takova vetëm të rinj të suksesshëm, por të rinj me vizion për Shkodren. Kanë vendosur që mos ta braktisin Shkodren, por të ndërtojnë të ardhmen këtu. Nuk duan të përsërisin gabimet e të tjerëve në të shkuarën, prandaj janë të motivuar ta ndryshojnë qytetin për mirë. Angazhohem që bashkia e së nesërme t'i ofrojë atë që i mungon më shumë: Meritokracinë dhe një Shkoder plot mundësi.</p>

			<p>#medashniperShkodren #votoXhemalBushati #voto3 #pd</p> <p>Kandidati i PD për bashkinë Shkodër Xhemal Bushati zhvilloi një takim në një prej kompanive më të mëdha në Shkodër Opportunity e cila ka rreth 600 punonjës, kryesisht të rinj. Kandidati Bushati: Dyert e bashkisë të hapura për rininë</p> <p>Kompanitë Call Center të cilat kanë një numër të konsiderueshëm punonjësish do të jenë në fokusin e kandidatit të PD për bashkinë Shkodër Xhemal Bushati. Një prej takimeve kandidati Bushati e zhvilloi tek Opportunity Group duke marrë mbështetjen e plotë të të rinjve të cilët janë të shkolluar, të trajnuar dhe një pjesë me eksperiencë në menaxhim si dhe me aftësi të larta në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Kandidati Bushati ofroi mbështetjen e plotë duke ftuar këta të rinj për të zhvilluar projektet dhe idetë e tyre duke i siguruar ata se dyert e bashkisë Shkodër do të jenë gjithmonë të hapura.</p> <p>Xhemal Bushati (kandidat i PD bashkia Shkodër): Po shoh që paska vetëm rini dhe do më pëlqente të trajtojme problemet e rinisë. Dyert e bashkisë do jenë të hapura për secilin prej jush dhe për gjithë qytetarët e Shkodrës. Ardhja këtu më krijon përgjegjshmëri kur shoh rininë e aktivizuar në këtë biznes të suksesshëm.</p>
--	--	--	---

				<p>Unë do takoj çdo biznesmen për ti pyetur për problematikat dhe për ti kërkuar mbështetjen e tyre. Kualifikimi i të rinjve është shumë i rëndësishëm dhe ne do ti gjejmë mënyrat. Çdo ide inovative do të ketë dyert e hapura në bashkinë Shkodër dhe do mirëpres secilin prej jush. Kam dhënë prova se di të bashkëpunoj me Fondin Amerikan të Zhvillimit dhe do ti ftoj të vijnë në Shkodër sërish për të investuar.</p> <p>Nin Kokaj (CEO Famiko Group): Një problem është mungesa e trajnimeve për të rinjtë përsa i takon drejtimit, menaxhimit dhe është e rëndësishme që bashkia të kontribuojë për rininë sepse për ata të rinj dhe biznese që kanë nevojë për menaxher të mirëpërgatitur do e kuptojnë rëndësinë e saj. Më përpara kam dashur të bëj diçka bashkë me bashkinë Shkodër për të financuar disa projekte dhe bashkia të siguronte organizimin e këtyre trajnimeve dhe mundësinë e sjelljes në Shkodër të personave të aftë por nuk ka patur asnjë iniciativë nga ana e bashkisë për këtë pjesë.</p> <p>Aurel Hasani (Drejtues Informatik): Kam patur mbështetjen e pronarit për të më financuar një projekt inovativ por nuk kam gjetur komunikimin e duhur nga ana e bashkisë Shkodër. Ka qenë një aplikacion për të parë vendndodhjen e autobuzëve, kohën se kur vijnë në stacion etj por bashkia Shkodër nuk ka gjetur gjuhën e përbashkët me mua për të më pritur për</p>
--	--	--	--	--

				<p>këtë projekt dhe shpresoj që në të ardhmen dyert e bashkisë të jenë të hapura për ne.</p> <p>Marsit Halluni (Përgjegjës Opportunity): Kemi nevojë për një qytet të pastër dhe me disa shërbime të tjera, na mungon transporti publik dhe për ne si kompani me shumë punëtorë është një shqetësim i madh.</p> <p>Ditmir Meçani (Departamenti i Operacioneve Opportunity Group): Unë jam një prej të rinjve që kam lënë Italinë për të ardhur dhe për të jetuar në Shkodër, qytetin tim. Nëse unë dua të ftoj miqtë e mi nga jashtë është e turpshme të vijmë dhe të shohim atë hyrje që ka qyteti aktualisht.</p> <p>Xhemal Bushati (kandidat i PD bashkia Shkodër): Hyrja e Shkodrës do të ketë një projekt. Ka qenë një projekt 370 milion lekë dhe asnjëherë nuk është vënë në zbatim. Ndryshimi në Shkodër do shihet që në muajin e parë.</p> <p>Audienca e synuar: Janë qytetarët dhe qytetarët shkodrane.</p>
6	Facebook/Xhemal Bushati	15/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja:</p> <p>Në frymën e bashkimit dhe me alternativën tonë për t'i dhënë Shkodrës më të mirën, bashkëndava me banorët e Postribës këtë pasdite. Është Shkodra bashkuesja më e mirë e jona! Bushati: Bashkim dhe Alternativa që zhvillojnë Shkodrën</p>

				<p>Ne nuk kemi ndërmend të bëjmë betejë tjetër, sesa nga ajo që na thërret e ardhmja e Shkodres. Beteja e vetme emergjente që ka sot Shkodra, është ajo e ndryshimit.</p> <p>Sa te urtësia, besoj edhe të zgjuarsia e shkodranve. Janë lodhur mjaftueshëm nga retorika e politikës së djeshme, por edhe kërkojnë zgjidhje. Zgjidhje për një qytet, ku unë dhe ata zgjohemi çdo ditë me hallet e njëri-tjetrit.</p> <p>Nuk di të flas gjuhën e ndasisë. Prandaj dora ime e bashkëpunimit me qytetarët mbetet e shtrirë për të vetmin qëllim: Ta rikthejmë Shkodrën në shinat e normalitetit.</p> <p>Audienca e synuar: Janë Banorët e Postribës.</p>
7	Facebook/Xhemal Bushati	16/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Vizitë tek një nga fasoneritë e Shkodres. Pata kënaqësinë të ndaja biseda me administratorët dhe çdo punonjës. Të diskutoja nga afër për shqetësimet e tyre për Shkodren si qytetarë, por edhe si punëmarrës.</p> <p>Kanë një jetë që paguajnë taksa, dhe me të drejtë kërkojnë shërbime. Kjo do të jetë A-ja e punëve tona të mira në Bashkinë e së nesërmes. Paratë e taksave t'ua kthejmë në shërbime dhe biznesit t'i ofrojmë lehtësirat e mundshme.</p> <p>Bashkia e së nesërmes nuk ka si të jetë dhe nuk do të jetë armike e biznesit.</p>

				<p>#medashniperShkodren #votoXhemalBushati #voto3 #pd Audiencia e synuar: Janë banorët e Shkodrës.</p>
8	Facebook/Xhemal Bushati	16/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Takim me banorët e Postribës. Postriba nuk mund të jetë larg vëmendjes. Ftesës sime të bashkimit i janë përgjigjur pozitivisht. Sepse Postriba nuk ka më kohë për të humbur. Meritojnë një Bashki që i përkrah dhe do ta kenë. Nuk kam ndërmend të bëj retorikë politike. Boll! Shërbime dhe punë për Shkodren e së ardhmes. Kam përkrah shumicën prej jush që duan ndryshimin dhe këtë do ta sjellim të gjithë bashkë.</p> <p>#medashniperShkodren #votoXhemalBushati #voto3 #pd Audiencia e synuar: Janë banorët e Zonës së Postribës.</p>
9	Facebook/Xhemal Bushati	17/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Me rininë shkodrane kemi një sfidë. T'i kthejmë shpresën Shkodrës dhe Shkodren, rinisë!</p> <p>#medashniperShkodren #votoXhemalBushati #voto3 #pd</p>

				Audienca e synuar: Janë të rinjtë e Shkodrës.
10	Facebook/Xhemal Bushati	17/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Ndhmën për ta ndryshuar Shkodren, po e kërkoj vetëm tek qytetarët e Shkodres. Tek asnjë i tretë. Kjo është e vetmja mbështetje që ka sot nevojë Shkodra. Shkodranët për Shkodren. Me banorët e Bërdicës folëm për angazhime dhe jo politikë. Me shumë dashni për Shkodren dhe larg mllefrit që nuk e çon Shkodren askund. Bërdica e meriton ndryshimin, e do ndryshimin dhe bashkë do e sjellim!</p> <p>#medashniperShkodren #votoXhemalBushati #voto3 #pd Audienca e synuar: Janë banorët e Bërdicës.</p>
11	Facebook/Xhemal Bushati	17/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Po mundohem të takoj këdo që e do Shkodren. Tek Famiko Group gjeta shembullin e suksesit. Kjo fasoneri e Shkodrës prodhon sot veshje sportive për Formula 1. Janë keto modele që na duhen për të ecur përpara. Falenderova çdo punonjës që janë pjesë e këtij sukseesi. Edhe pse kanë hasur vështirësi nuk e kanë braktisur Shkodren. E në këtë garë me të ardhmen, më premtuan se nuk do ta braktisin.</p>

				<p>Por do të bëhen pjesë e fitores së Shumicës, e fitores së Shkodres.</p> <p>#medashniperShkodren #votoXhemalBushati #voto3 #pd Audiencia e synuar: Janë Banorët e Shkodrës.</p>
12	Facebook/Xhemal Bushati	18/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Sot së bashku me Gentën, vajzën time dhe shumë të rinj shkodran vizituam Muzeun e Memories me një qëllim të veçantë. Firmosëm Peticionit për Dekomunistizim dhe Drejtësi. Një Peticion që kërkon të mbyllë kapitullin më të errët për Shkodren.</p> <p>Peticioni synon t'i ofrojë shoqërisë shqiptare një kuadër ligjor që mundëson të drejtën që ka çdo shoqëri për të njohur të vërtetën mbi ngjarje të rëndësishme historike, siç është periudha e diktaturës komuniste.</p> <p>Si shumë familje të tjera, edhe familja ime nuk ka një të kaluar të lehtë, janë plagë që nuk harrohen. Këtë i kërkova edhe të rinjve sot. Se një e ardhme nuk ngrihet mbi harresën e së djeshmes dhe indiferencën. E më së tepërmi, të jenë mur i së keqës dhe pararojë e së ardhmes.</p>

				<p>Synimi final i peticionit është ndalimi i propagandës komuniste në publik, ndalimi i simboleve komuniste dhe i glorifikimit të figurave të regjimit; rishikimi i teksteve shkollore që ende nuk e trajtojnë siç ka qenë atë kohë dhe muzealizimin e ngritjen e memorialeve.</p> <p>Njëherësh, rishikimi i emrave të shkollave dhe rrugëve që ende mbajnë emra të vënë që gjatë regjimit e për të cilët nuk ka dakordësi publike mbi rolin e tyre gjatë regjimit dhe as mbi mesazhin kontravers që u japin brezave.</p> <p>Ky peticion vjen si një iniciativë nga shoqëria civile (IDMC).</p> <p>Unë, jam i vendosur si qytetari i parë i Shkodrës ta mbështesë atë në emër të mijëra shkodranëve, vëllezërve dhe motrave të përndjekur e burgosur në diktaturë, dhe ju ftoj edhe juve ta bëni firmosjen e këtij pyetësi.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë Banorët shkodranë.</p>
13	Facebook/Xhemal Bushati	18/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Me njerëz të mirë e punëtorë tek Famiko Group, që i bashkohen Ndryshimit!</p>

				<p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë banorët e Shkodrës.</p>
14	Facebook/Xhemal Bushati	18/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Për Shkodren e ndryshimit, të bashkimit dhe të fitores. Këte të Shtunë, ora 11:00, në Pedonalen e qytetit (përballë “Hotel Colosseo”), kandidati i Partisë Demokratike, Xhemal Bushati, ju fton në hapjen e fushatës dhe shpalosjen e programit të tij. I pranishëm edhe kryetari i Partisë Demokratike, Z. Lulzim Basha.</p> <p>Shkodra nuk ka kohë më për të humbur. Shkodra duhet të ndryshojë dhe vetëm bashkë mundemi!</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë të gjithë qytetarët e Shkodrës.</p>
15	Facebook/Xhemal Bushati	19/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: #LulzimBasha #LIVE - Në Shkodër në hapjen zyrtare të fushatës, për të mbështetur kandidatin fitues për bashkinë, Xhemal Bushati</p>

				Audienca e synuar: Janë Qytetarët e Shkodrës.
16	Facebook/Xhemal Bushati	19/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: “Shkodra duhet të jetë jo vetëm votra e gjyshërve dhe muzika që mbajmë mend nga fminia, por duhet të jetë ndalesa, qendra dhe graviteti që na ripret tek rikthehemi edhe këtë herë me mundësi plot. Ky është premtimi i babit tim, jo vetëm karshi meje, por karshi Shkodres.”</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë banorët e Shkodrës.</p>
17	Facebook Xhemal Bushati	19/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Emiljano Pjetri, shef i Departamentit të infirmierisë në Universitetin e Shkodrës: Fëmijët e Shkodrës, ata kanë rëndësinë, mjediset ku mësojnë, ata kanë rëndësi, qendrat ku kryejnë aktivitete, ata kanë rëndësi, qendrat ku marrin shërbim shëndetësor, ata kanë rëndësi, rrugët ku ecin ata kanë rëndësi, trajtimi i mbetjeve ata kanë rëndësi, biznesi, ai ka rëndësi, të gjitha këto i ka parasysh Xhemal Bushati.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë banorët e Shkodrës.</p>

18	Facebook Xhemal Bushati	19/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Xhevdet Amuli, kryetar i PD Shkodër: Shkodra ka treguar gjithnjë se është qyteti i qytetarëve të lirë, i njerëzve demokrat në shpirt, qyteti që ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë Partinë Demokratike.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë banorët e Shkodrës.</p>
19	Facebook Xhemal Bushati	19/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Nektar Duma, arkitekt, specialist tek Drejtoria e Planifikimit, Bashkia Shkodër: Në situata të tillë të vështira, e komplekse alternativat për lidhshmëri numërohen me gishtat e njëjës dorë, gjë shumë pak. Kërkohej një njeri i mençur, dinamik por i matur, andrrimtar por me këmbë në tokë, i ndershëm por jo naiv, që të di të bie në ujdi por që nuk bën pazare në kurriz të qytetit dhe përballet me kurajo me problematikat e qytetit dhe di të bashkojë qytetarët në vendimarrje dhe të zbusë diferencat mes tyre. Ky person është Xhemal Bushati.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati</p>
	Facebook/Xhemal Bushati	19/02/2022		<p>Audienca e synuar: Janë Banorët e qytetit të Shkodrës. Përmbajtja:</p>

20			Xhemal Bushati	<p>Franko Burraj, atlet i Vllaznisë, nënkampion Ballkani:</p> <p>Si një sportist i ri ndjem i përfaqësuar nga Xhemal Bushati, për vlerat që mbart dhe e di dashamirësinë që ka për sportin ndaj kam vendosur që të jap mbështetjen time. Kam besim se dera e të rinjve do jetë gjithmonë e hapur nga ana juaj.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë qytetarët e Shkodrës.</p>
21	Facebook/Xhemal Bushati	19/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja:</p> <p>Lulzim Basha, Kryetar i PD:</p> <p>Xhemali në një nga bisedat më përpara më ka thënë tre fjalë që i kam dëgjuar edhe nga shkodran të tjerë ‘Shkodra asht dashni’. E vërteta është që Shkodra asht dashni, e vërteta është që Xhemal Bushati është kandidati më i mirë për Shkodrën. E di se don ta bëjë Shkodrën më të mirë, më të jetueshme, e di se në zemër ka dëshirën për t’i shërbyer çdo kujt, pa dallim. Vota për Xhemal Bushatin.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren</p>

				Audienca e synuar: Janë Banorët e qytetit të Shkodrës.
22	Facebook/Xhemal Bushati	19/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Shkodra është familja jonë e madhe ndaj të cilës pas 6 Marsit, sëbashku do të punojmë me dashni dhe përkushtim.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë banorët e Shkodrës.</p>
23	Facebook/Xhemal Bushati	19/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Sytë e shkodranve janë nga Shkodra. Tiktaku i ndryshimit po vjen dhe shkodranët e konfirmuan në sheshin e Shumicës. Bashkohemi rreth vlerave dhe së ardhmes. Bashkimi për të ardhmen e Shkodres është forca jonë. Me 6 Mars: Shkodren, shkodranve!</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë Banorët e qytetit të Shkodrës.</p>
24	Facebook/Xhemal Bushati	20/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Rrëzimi i bustit të Enverit sot nuk është vetëm një datë. As një kujtesë, por shembulli i papajtueshmërisë me të keqen.</p>

				<p>E përkujtoj edhe sot indinjatën e Shkodrës. Edhe pse u munduan ta shuajnë, temperatura e vlimit ishte gjithmonë ne zemrat e shkodranëve. Një Shkodër që nuk diti kurrë të përkulej, as në ato ditë.</p> <p>Sado të thella të jenë rrënjët e së keqes, shqiptarët dhe shkodranët kanë tregur se i ç'rrënjosin ato. E nën shembullin e rrëzimit të mureve të së keqes, të ndërtojmë një të ardhme më të mirë.</p> <p>Për Shkodren dhe Shqipërinë!</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar Janë banorët e Shkodrës.</p>
25	Facebook/Xhemal Bushati	20/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Në Anën e Malit, nuk shkoj për herë të parë. E sidomos, nuk shkoj vetëm për fushatë. Lidhëm besën, për angazhime dhe jo politikë. Ana e Malit, nuk ka nevojë për retoriken e së shkuarës. Kam çfarë i premtoj, prandaj isha vetëm me ekipin tim të Shkodres. Kjo është e vetmja ndihmë për ndryshimin. Dhe më premtuan që do t'i bashkohen ndryshimit. Shkodren, shkodranve!</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren</p>

				Audienca e synuar: janë banorët e Qafës së Malit.
26	Facebook/Xhemal Bushati	20/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Shkodren, shkodranve!</p> <p>Kjo nuk asht beteja jeme, asht ndryshimi që na e dikton Shkodra. Dora ime e bashkëpunimit asht e shtrime për secilin prej jush. Ta kthejmë këtë sfidë në një mision. Me një plan emergjent, vendosim Shkodrën në shinat e suksesit. Me dashni dhe përkushtim, jo për veten, por për Shkodren.</p> <p>Jam njëri nga ju, nuk di të zhgënjej dhe nuk do të zhgënjej. BASHKË!</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë Banorët e qytetit të</p>
27	Facebook/Xhemal Bushati	21/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Jo rastësisht, legjenda e Shkodrës fillon me figurën e gruas. Kam dëgjuar nga afër shumë nga historitë e tyre, sakrificat, por kurrë nuk pashë lodhjen për fëmijët e tyre, familjet dhe për Shkodren. Po gjej kohën t'i dëgjoj dhe të diskutoj, por me ngulm, përultësisht t'i falenderoj.</p> <p>Le të ndërtojmë një Shkodër më të mirë për gratë, nënat dhe motrat tona.</p>

				<p>Sepse edhe pas një Shkodre të suksesshme, qëndrojnë gra të suksesshme!</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë Famrat e Shkodrës.</p>
28	Facebook/Xhemal Bushati	21/02/2022	Xhemal Bushti	<p>Përmbajtja: Artizanati në Shkodër është një nga trashëgimitë identifikuese. I kanë dhënë shumë Shkodres dhe kanë marrë pak përkrahje. Meritojnë përkrahjen dhe vëmendjen e duhur. I shpreha të gjithë mirënjohjen time, por edhe sigurinë për të nesërmen: Se do të kenë një Bashki përkrah!</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: janë banorët e Shkodrës.</p>
29	Facebook/Xhemal Bushati	22/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Kandidati i PD për bashkinë Shkodër Xhemal Bushati zhvilloi një takim në fasoneri Melgushi në Shkodër duke u njohur nga afër me problematikat e këtij biznesi. Kandidati Bushati u njoh me problemet e punonjësve të cilët shqetësim kryesor kanë emigrimin e fëmijëve të tyre. Kandidati Bushati: Të bashkohemi me 6 mars, shmangni indiferentizmin</p>

				<p>Kandidati Bushati tha se kryefjalë e tij është ndryshimi i situatës qoftë për biznesin por edhe për qytetarët.</p> <p>“Në Shkodër ka akoma shembuj suksesi. Biznesi has çdo ditë vështirësi dhe nuk është aspak e lehtë. Kryefjala është Ndryshimi. Dhe kjo na bashkon. Kam një mision në këtë sfidë tonën, t’ia kthejmë vendim-marrjen qytetarit. Bashkia e së nesërmes do te jetë përkrahësja më e madhe e biznesit. Me një Bashki për qytetarët, Shkodra do të ecë përpara”, u shpreh kandidati Bushati.</p> <p>Audienca e synuar: Janë Banorët e qytetit të Shkodrës.</p>
30	Facebook/Xhemal Bushati	22/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Në Shkodër ka akoma shembuj suksesi. Biznesi has çdo ditë vështirësi dhe nuk është aspak e lehtë. Kryefjala është Ndryshimi. Dhe kjo na bashkon. Kam një mision në këtë sfidë tonën, t’ia kthejmë vendim-marrjen qytetarit. Bashkia e së nesërmes do te jetë përkrahësja më e madhe e biznesit. Me një Bashki për qytetarët, Shkodra do të ecë përpara.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren</p> <p>Audienca e synuar: Janë Banorët e Shkodrës.</p>
31	Facebook/Xhemal Bushati	23/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Sa herë ulem për të diskutuar me të rinjtë, bindem edhe më shumë se 6 Marsi do të jetë fitorja e Shkodres. Nuk janë pozicionuar përkrah meje, por jemi ne që jemi rreshtuar kra</p>

				<p>tyre. Sepse e ardhmja e Shkodrës është beteja e tyre. Mora përgjigje për shumë pyetje. I sigurova për diçka. Ka ikur koha që kriter për punësimin e tyre ishte familja. Kjo merr fund! E duan ndryshimin dhe do të jenë në krye të kësaj sfide. Bashkia e së nesërme do të jetë e hapur për më të mirët. I kërkova që mos të dorëzohen, por ta mbajnë ndezur shpresën e ndryshimit.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë të rinjtë dhe të rejtat e Shkodrës.</p>
32	Facebook/Xhemal Bushati	23/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Në djepin e artit, mendimi dhe zëri i artistëve nuk do të jetë kurrë dytësor. Me Fatmir Jukën, drejtor i Galerisë së Arteve, diskutuam mbi shumë tema që ndikojnë artin dhe Shkodrën. Vështirësitë u kanë mbyllur dyert krijimtarisë dhe ideve të tyre. Meritojnë më shumë përkrahje dhe do ta kenë të pakursyer nga ana ime. Unë e kam një projekt për ta zbatuar, që kurrë nuk gjeti vullnetin e të tjerëve. Në fakt e kam kërkuar që kur isha kryetar i Këshillit Bashkiak. Ta kthejmë ndërtesën në të cilën sot ndodhet Këshilli i Qarkut Shkodër, në një muze, në një shtëpi më shumë për artin. Bashkë, ta kthejmë Shkodrën aty ku i takon, në</p>

				<p>pedestalin e identitetit! #voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë Banorët e Shkodrës.</p>
32	Facebook/Xhemal Bushati	24/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Ditën sot e nisa me shoqëri të mirë, tek qendra e të moshuarve “Te zotërinjtë”. U gëzova për standardin dhe kushtet e krijuara. Respektin dhe kujdesin tim të veçantë do ta kenë këta zotërinj dhe zonja, që ndanë me mua pak nga e përditshmja e tyre. Nën fokus gjithashtu edhe qendrat e tjera, si publike ashtu edhe private, për të krijuar një strehë të ngrohtë për këta qytetarë të mirë.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar Janë Të moshuarit e Shkodrës.</p>
33	Facebook/Xhemal Bushati	24/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Tryeza me drejtues të OJF-ve në Shkodër.</p> <p>Pata kënaqësinë të ndanim bashkë vizionin për Shkodren. Kanë gjetur pengesa, megjithatë kanë bërë çmosin që t’i japin Shkodres. U njoha me shumë projekte dhe plane të tyre për Shkodren dhe i shpreha garancinë se do t’i përkrah. Projektet e bukura nuk do të pluhrosen në sirtaret e Bashkisë. Askush nuk do të jetë pengesë e ndryshimit të Shkodres.</p>

				<p>I premtova dorën e bashkëpunimit për një Shkodër më të mirë!</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren</p> <p>Gjatë një bashkëbisedimi të hapur me përfaqësues të OJF-ve këto ishin disa nga problematikat dhe shqetësimet e tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nëse Bashkia Shkodër bashkëpunon me OJF, fitimtarë do të jenë qytetarët e Shkodrës. - OJF-të të ftohen në tryeza të shumta, në mënyrë që sëbashku të bëjmë planin strategjik të zhvillimit. - Shumë nga donacionet kanë humbë në qytetin e Shkodrës sepse nuk i kanë gjetur dyert e hapura nga Bashkia. - Krijimi i një Bordi të Bashkisë i formuar nga Shoqëria Civile. <p>Audienca e synuar: Janë aktivistët e qytetit të Shkodrës.</p>
33	Facebook/ Xhemal Bushati	25/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Tryeza me operatorë dhe sipërmarrës turistik. Det, lumenj, liqen, male, alpe, kala, histori mijëra vjeçare. Cili qytet përveç Shkodrës? Jemi Shkodra! Këtë luks që na e ka falur natyra, kemi kohë që e shfrytëzojmë për keq. Jemi qyteti me potencialin më të madh turistik dhe nuk duhet ta</p>

				<p>harrojmë. Këtë diskutuam me sipërmarrësit dhe operatorët. Ekonomia e Shkodrës mund të lulëzojë sikur të investohej më shumë për turizmin. Sikur të kishte një bashkëpunim më të mirë mes nesh. Sikur mendimi i tyre të konsiderohej jo vetëm në një ditë dhe t'i mundësohen lehtësirat e nevojshme. Unë nuk premtoj të pamundurën, por brenda pak kohësh, bashkë do ta kthejmë Shkodrën në destinacionin numër 1 të turistave në Shqipëri. #voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren</p> <p>Audienca e synuar : Janë Banorët e Shkodrës.</p>
34	Facebook/Xhemal Bushati	Ora 12:20 PM Data 27/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Shkodren, shkodranve!</p> <p>Shkodranët janë përkufizimi më i bukur i fitores. Në çdo dyer që trokasim gjejmë sigurinë për ndryshimin e madh.</p> <p>Tek banorët e rajonit 5, gjeta mbështetjen, shpresën dhe dashninë për Shkodren e Ndryshimit. Kanë pse të ndihen të zhgënjyer, por më vjen mirë që dinë ta ndajnë të mirën nga e keqja.</p> <p>6 Marsi është fitorja e Shkodrës përballë interesave personale. Bashkimi përballë përçarjes.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati</p>

				#medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë qytetarët e Shkodrës.
35	Facebook/Xhemal Bushati	Ora 13:30 PM Data 27/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Super entuziazmi i takimit të sotëm me gratë shkodrane është garancia e ndryshimit që po vjen për Shkodren. Shpalosëm një tjetër model për Shkodren. Modelin e përkushtimit dhe të dashnisë për Shkodren përballë modelit të interesave dhe përplasjes. Jemi me fat që në këtë mision tonin për Shkodren kemi bekimin e nënave dhe guximin e grave shkodrane. Kjo është Super Shkodra që të gjithë njohim, Super Shkodra që të gjithë duam!</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë Femrat e Shkodrës.</p>
36	Facebook/Xhemal Bushati	Ora 14: 00 PM Data 28/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Jorida Tabaku, Deputete, Nënkryetare e PD: Është shumë e rëndësishme që Shkodrës t'i kthehet ajo bukuria, ai shkëlqim që ka patur gjithmonë, është shumë e rëndësishme që Shkodra të ketë këtë pamje që keni ju sot, e të vazhdojë të jetë ajo pika blu tek harta e kuqe që zemra jonë e demokratëve të vazhdojë të rrahë</p>

				<p>dhe t'i japim një shpresë të gjithë Shqipërisë që si e theu Shkodra do ta thejmë ne nesër.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë femrat Shkodrane dhe familjet e tyre.</p>
37	Facebook/Xhemal Bushati	Ora 14:30 PM Data 28/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Emilia Koliqi, Deputete e PD, Qarku Shkodër: Unë besoj se Shkodra ashtu si ka qëndruar bastion i PD për 31 vite, do të mbetet e tillë si një shembull i përhershëm demokracie për të gjithë Shqipërinë. Të gjithë bashkë t'i shfrytëzojmë këto ditë që kanë mbetur dhe të punojmë për fitoren e Z. Bushati dhe për fitoren e Partisë Demokratike.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë Qytetarët e Shkodrës.</p>
38	Facebook Xhemal Bushati	Ora 14:45 PM Data 28/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Helga Sallaku, Pedagoge, Përfaqësuese e Gruas PD Shkodër: Është vlerë për mua të jem sot në krah të Partisë Demokratike. Është privilegj për mua ta hap këtë takim. E duke ju njohur secilën prej jush sot që e keni mbushur këtë sallë dhe e keni bërë kaq të bukur, unë do ta filloj këtë</p>

				<p>takim me një realitet ku secila prej nesh e ka prekur këtu në Shkodrën tonë dhe kudo në Shqipërinë tonë. Fëmijët po ikin përditë. Këtu në Shkodër fatkeqësisht lëvizja e lirë është kthyer nga luksi më i madh në dhimbjen tonë më të madhe.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë familjet e Shkodrës.</p>
39	Facebook/Xhemal Bushati	Ora 15:00 PM Data 28/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Greta Bardeli, deputete e PD Qarku Shkodër: Me Albanen në krah, me familjen tëndë në krah, na nderove të gjithëve. U bërë zë, I atyre zërave që ishin të stopuar ose shumë të heshtur dhe i premtove që ky qytet do të ndryshojë. Unë kam besimin e plotë që çdo njëra nga ne sot do japim mbështetjen tonë jo vetëm me votën tonë por edhe të gjithë familjarëve, miqve dhe kolegëve tanë. Të uroj fitoren e padiskutueshme dhe i falenderoj gjithë këto vajza e gra që janë sot këtu me ne dhe bashkëndajnë këtë mendim.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar:</p>

				Janë qytetarët, familjet, femrat Shkodrane.
40	Facebook/Xhemal Bushati	Ora 15:20 PM Data 28/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Françeska Pjetri Kola, Studente e Arteve: Unë besoj tek një familjar i rregullt, unë besoj tek një biznesmen i sukseshëm, unë besoj tek Z. Xhemal Bushati. Besoj tek e ardhmja e rinisë së Shkodrës, tek arti, tek kultura dhe kam besimin e plotë që zgjedhja më e mirë për të ardhmen e Shkodrës është Xhemal Bushati.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë femrat, familjet, dhe qytetarët e Shkodrës.</p>
41	Facebook/Xhemal Bushati	Ora 15: 30 Data 28/02/2022	Xhemal Bushati	<p>Përmbajtja: Do të bashkëdrejtoj me qytetarët e Shkodrës, por në radhë të parë unë do të bashkëdrejtoj bashkinë e Shkodrës me gratë intelektuale. Më ka takuar t'ju shtrëngoj dorën shumë grave, shumë nënave. Ato më kanë shprehur besimin e tyre. Ju jeni drita e këtij qyteti. Më shumë vëmendje për ju, më shumë kujdes për ju dhe më shumë punësim për ju.</p> <p>#voto3 #pd #votoXhemalBushati #medashniperShkodren Audienca e synuar: Janë femrat dhe qytetarët e Bashkisë Shkodër.</p>

